LIGJ
Nr.9617, datë 16.10.2006

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E MBROJTJES DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË ITALISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME, PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT "FUQIZIMI I QENDRËS TRAUMATOLOGJIKE KOMBËTARE TË TIRANËS""

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, të përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, për realizimin e programit "Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës"".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5091, datë 2.11.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E MBROJTJES DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS ITALIANE, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME

Në vijim të quajtura "Palët Kontraktuese" për realizimin e programit "Fuqizim i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës"

Duke pasur parasysh:

se në protokollin e bashkëpunimit për trevjeçarin 2002-2004, Qeveria Italiane ka marrë përsipër të financojë një ndërhyrje për fuqizimin e Qendrës Traumatologjike Kombëtare dhe për të përmirësuar funksionalitetin e saj, duke përcaktuar për këtë qëllim një kredi ndihmëse prej 5 000 000,00 euro dhe një donacion prej 150 000,00 euro;

se në mbledhjen e datës 16 maj 2005 Komiteti Drejtues i Ministrisë së Punëve të Jashtme (MPJ) është shprehur pro dhënies së një kredie ndihmëse prej 5 000 000,00 dhe vendosi dhënien e një donacioni prej 150 000,00 euro për realizimin e ndërhyrjes "Fuqizim i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës", në vijim i quajtur Programi, parashtruar gjithë sa më sipër,

Palët Kontraktuese ranë dakord për sa vijon:

Neni 1
Qëllimi dhe Palët e Marrëveshjes

a) Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është të rregullojë angazhimet e ndërsjellta të dyja Palëve për zbatimin e saktë të Programit, duke iu referuar në veçanti modaliteteve të dhënies së kontratave, si dhe atyre të menaxhimit/llogaritjes/livrimit të fondeve të kredisë ndihmëse.

b) Kjo Marrëveshje përbëhet nga 15 nene dhe nga 3 anekse, siç janë treguar në vijim, të cilat janë pjesë përbërëse të saj:

1. përmbledhje e Programit;
2. prokurimi i shërbimeve, furnizimeve e punimeve (kushtet e veçanta);
3. modalitetet e zbatimit dhe të administrimit të kredisë së ndihmës.

Neni 2

Objektivat e Programit

a) Objektivi i përgjithshëm i Programit është i vetëm dhe qëndron në përmirësimin e gjendjes së shëndetit të popullsisë shqiptare, në mënyrë të veçantë të popullsisë së prekur nga trauma.

b) Objektivat specifikë kërkojnë të bëjnë më efiçentë e më efikasë veprimtarinë terapeutike të Qendrës Traumatologjike Kombëtare, duke rritur në këtë mënyrë ndikimin mbi shëndetin e popullsisë dhe njëkohësisht për të përmirësuar prognozën *quod valitudinem* të pacientëve politraumatikë me pasojë uljen e paaftësive të përkohshme dhe të përhershme dhe të kostove që lidhen me to.

Neni 3

Përshkrimi i Programit

a) Programi është përcaktuar shkurtimisht në aneksin 1 dhe synon të arrijë pajisjen e Qendrës Traumatologjike Kombëtare me aparaturat e duhura mjekësore dhe ta bëjë atë të përshtatshme për rolin që ajo ka si pikë referimi kombëtare për pacientët e traumatizuar.

b) Zbatimi i Programit shpie në furnizimin me:

- pajisje mjekësore dhe orendi;
- një shërbim asistence teknike, mirëmbajtje dhe trajnimi të specializuar;
- përpos garancisë së zakonshme të pajisjeve;
- një sasi të përshtatshme materialesh konsumi për QTK.

Neni 4

Institucione të përfshira në realizimin e Programit

Institucionet e përfshira në realizimin e Programit janë si vijon:

a) Për Palën Italiane:

1. MPJ/DPKZH (Ministria e Punëve të Jashtme/Drejtoria e Përgjithshme për Bashkëpunim për Zhvillim) që do të sigurojnë livrimin e burimeve financiare me kredi, sipas mënyrave të parashikuara nga kuadri ligjor italian në fuqi, e që përmbledhtazi tregohen në këtë Marrëveshje. MPJ/DPKZH, në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes (MM) Shqiptare, do të kenë gjithashtu për detyrë të kontrollojnë ecurinë e Programit dhe aftësinë e tij për të arritur rezultatet e treguara në nenin 3 të mësipërm. MPJ/DPKZH do të veprojnë përmes zyrave kompetente për kryerjen e detyrave të veta. Në veçani, Zyra Teknike Qendrore e MPJ/DPKZH, në vijim e quajtur ZTQ, do të garantojë të gjitha funksionet me karakter teknik në mbështetje të realizimit të Programit.

2. Artigiancassa që - sipas udhëzimeve të MPJ/DPKZH dhe të Ministrisë së Ekonomisë Italiane – do të lidhë me Ministrinë e Financave Shqiptare (MF) një marrëveshje financiare që do të rregullojë përdorimin e fondeve të kredisë ndihmëse. Në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje financiare, Artigiancassa do të kujdeset për lidhjen e kontratave të veçanta për livrimin e të mirave, shërbimeve dhe punimeve, përmes të cilave do të realizohen veprimtaritë e parashikuara në Program. Do të kujdeset gjithashtu për të siguruar pagesën e shumave të kontratave në favor të organizmave realizues.

3. Ambasada/ZTL (Zyra Teknike Lokale) në Tiranë, e cila do të garantojë të gjitha funksionet me karakter teknik të nevojshme për të siguruar ecurinë e rregullt të punimeve. Në kuadrin e funksioneve të veta institucionale, Ambasada/ZTL do të sigurojë gjithashtu kontaktet e nevojshme me kundërpalët e Programit, duke u kujdesur, ndër të tjera, për marrjen dhe përcjelljen e gjithë dokumentacionit zyrtar.

b) Për Palën Shqiptare:

1. MM, e cila do të sigurojë zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje, duke përfshirë strukturat e tjera kompetente shqiptare (në veçanti Ministrinë e Shëndetësisë) dhe do të kujdeset të bashkërendojë funksionet me karakter teknik dhe drejtues të nevojshme për realizimin e Programit.

2. MF, e cila do të lidhë Marrëveshjen financiare me Artigiancassa dhe do të kujdeset për kontaktet operative me këtë të fundit, sipas sa përcaktuar në Marrëveshjen financiare.

Neni 5

Burimet financiare dhe modalitetet e përdorimit të kredisë së ndihmës

a) Burimet financiare të nevojshme për realizimin e Programit janë si vijon:

1. Kredia ndihmëse prej 5 000 000 euro për realizimin e të gjitha veprimtarive të parashikuara në Program.

2. Donacion prej 150 000 euro për veprimtaritë e kontrollit dhe asistencës teknike si gjatë shpalljes së tenderave, ashtu dhe gjatë zbatimit të veprimtarive të Programit.

b) Afatet dhe kushtet e kredisë ndihmëse janë si vijon:

- periudha e kthimit të kredisë: 19 vjet
- periudha e faljes (për kthimin e kredisë): 8 vjet
- përqindja e interesit vjetor: 0.20%.

c) Në bazë të procedurave në fuqi pranë MPJ/DPKZH, fazat kryesore, që duhen ndjekur për përdorimin e fondeve të kredisë ndihmëse, janë si më poshtë (më mirë specifikuar në aneksin 3):

1. nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje;

2. nxjerrja nga ana e Ministrisë së Ekonomisë Italiane e një urdhri ministror, që autorizon Artigiancassa të negociojë dhe nënshkruajë Marrëveshjen financiare me Ministrinë e Financave;

3. lidhja e Marrëveshjes financiare mes Artigiancassa dhe MF;

4. përgatitja e dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i tenderit, për të përcaktuar ata që do të ofrojnë furnizimet, shërbimin e asistencës, mirëmbajtjes dhe trajnimit me shpalljen e tenderit në Itali (në ngarkim të MPJ/DPKZH) dhe në Shqipëri (në ngarkim të MM);

5. vlerësimi i ofertave nga ana e komisionit të ngritur nga MM dhe shpallja, me klauzolë pezulluese, e fituesit të tenderit;

6. verifikim, nga ana e MPJ/DPKZH, i përputhshmërisë së procedurës së ndjekur për përzgjedhjen dhe kontratat që do të lidhen, dhe në rast përfundimi pozitiv, kjo e fundit do të japë *no objection* (miratohet pasi nuk ka kundërshtime) për lidhjen e kontratës së furnizimit nga ana e MM;

7. lidhja dhe llogaritja e kontratave mbi bazën e Marrëveshjes financiare, me modalitetet e livrimit të fondeve të treguara në aneksin 3.

Neni 6

Monitorimi i Programit – komiteti drejtues

a) Programi do të monitorohet përmes një komiteti drejtues, i përbërë nga dy anëtarë të caktuar, njëri nga MPJ/DPKZH dhe tjetri nga MM.

b) Komiteti do të ketë për detyrë të monitorojë veprimtaritë, e në veçanti:

- marrëdhëniet mes institucioneve të përfshira në Program;
- shqyrtimin e dokumentacionit të tenderit përgatitur nga përfituesi i tij dhe të asistojë, nëse do të jetë e nevojshme, përgatitjen e tenderit në lidhje me procedurat e prokurimit;
- të ndihmojë grupin e ekspertëve shqiptarë të përcaktuar nga MM;
- të monitorojë dhe vlerësojë realizimin e Programit.

c) Gjatë mbledhjeve të komitetit drejtues duhet të merren parasysh propozimet dhe masat e përbashkëta për fazat e mëtejshme të realizimit.

d) Duhet të merret mendimi i komitetit për çdo vendim në lidhje me Programin, e ky i fundit mund të merret vetëm me pëlqimin e vetë komitetit.

e) Në përfundim të Programit do të thirret një mbledhje për të bërë një analizë përfundimtare të kontrollit të veprimtarive të Programit.

Neni 7

Mënyrat e përfitimit të shërbimeve, furnizimeve dhe punimeve

a) Përcaktimi i zbatuesve të veprimtarive të Programit do të kryhet përmes kryerjes së tenderave të rregulluar nga dispozita që përmban Manuali i Procedurave (përftuar nga Komisioni Europian më 23 dhjetor 2002), në lidhje me “Prokurime shërbimesh, furnizimesh dhe punimesh në kuadrin e bashkëpunimit të Komunitetit Europian me vendet e treta”, si dhe nga sa saktësuar në aneksin 2.

Neni 8

Detyrime të Qeverisë Italiane

a) Qeveria Italiane merr përsipër të sigurojë financimin:

- deri në 5 000 000, 00 euro si kredi ndihme, që do të jetë e disponueshme pranë Artigiancassa dhe do të livrohet sipas sa saktësuar në aneksin 3;
- deri në 150 000,00 euro, si donacion, që do të administrohet drejtpërsëdrejti nga MPJ/DPKZH për kontraktimin e ekspertëve dhe konsulentëve për veprimtarinë e kontrollit dhe menaxhimit të kredisë.

Neni 9

Detyrime të Qeverisë Shqiptare

a) Qeveria Shqiptare merr përsipër:

- të vërë në dispozicion burimet financiare në kompetencë të saj, të barabarta me rreth 1 000 000, 00 euro të barasvlefshme;
- t'i bëjë operative të gjitha veprimet, veprimtaritë dhe aktet zyrtare të domosdoshme për përfundimin me sukses të Programit;
- të bashkëpunojë me MPJ/DPKZH për veprimtaritë e monitorimit të Programit, sipas nenit 6, edhe që kjo e fundit të mund të ketë akses ndaj dokumentacionit ekzistues dhe në hapësirat ku ai vepron.

Neni 10

Klauzola antikorrupsion

a) Qeveria Italiane është angazhuar në luftën kundër korrupsionit në të gjitha format e shfaqjes së tij. Në veçanti, me qëllim që të shmanget çdo rast veprimtarie e paligjshme dhe parregullsie gjatë paraqitjes së ofertave për furnizimet, shërbimet dhe punimet civile, Qeveria Italiane ka parashikuar për të gjithë pjesëmarrësit në tender detyrimin për të nënshkruar dhe paraqitur një *Integrity Pact*, së bashku me ofertat e tyre apo me kontratat e miratuara. Mosparaqitja e *Integrity Pact* do të shpjerë në përjashtimin e menjëhershëm nga tenderi dhe mosrespektimi i kësaj gjëje gjatë zbatimit të kontratës së miratuar do të përbëjë arsye për të zbatuar sanksionet e ndjeshme të parashikuara në të. Parashikimi i kësaj klauzole synon të sigurojë një konkurrencë të rregullt dhe mundësi të barabarta për të gjithë pjesëmarrësit në tender, si dhe një zbatim të saktë e transparent të kontratës së miratuar.

Neni 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

a) Çdo mosmarrëveshje që do të lindë mes Palëve Kontraktuese në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet, përsa të jetë e mundur, me anë të këshillimit dhe negociatave.

Neni 12

Pengesa dhe forca madhore

a) Në rast pengese për realizimin e Programit, për shkaqe të forcës madhore (luftë, përmbytje, zjarr, tufan, tërmet, konflikte në punë, greva, masa e urdhra të marrë nga qeveritë përkatëse, vështirësi të paparashikuara në transport e shkaqe të tjera) të njohura nga të dyja Palët, apo në rast rreziku apo kushtesh të rrezikshme për personelin e ardhur nga jashtë vendit, do të gjejnë zbatim dispozitat e mëposhtme, mbështetur në rekomandimet e kryesisë së Këshillit të Ministrave të Shqipërisë dhe të miratuara nga MPJ/DPKZH:

1. Nëse kohëzgjatja e pengesës për realizimin e Programit është më e vogël se gjashtë muaj, përdorimi i fondeve të papërdorura deri atëherë pezullohet deri kur MPJ/DPKZH do të autorizojë rifillimin e veprimtarive.
2. Nëse kohëzgjatja e pengesës është më e madhe se gjashtë muaj dhe më e vogël se njëzet e katër, Programi pezullohet dhe fondet e papërdorura mbahen, deri sa pengesa të mos ekzistojë më dhe të mbërrijë autorizimi i MPJ/DPKZH për rifillimin e veprimtarive.
3. Nëse kohëzgjatja e pengesës do të jetë më e madhe se njëzet e katër muaj, Palët janë të detyruara të merren vesh mbi vazhdimësinë e Programit dhe të përcaktojnë radhën e veprimeve. Në rast se vazhdimësia e veprimtarive do të jetë e pamundur, Palët duhet të vendosin mbi përdorimin e fondeve të papërdorura.

Neni 13

E drejta e MPJ/DPKZH për zgjidhjen e Marrëveshjes

a) MPJ/DPKZH ruan të drejtën për të hequr dorë nga Marrëveshja në këto raste:

1. Mosrealizim i veprimtarive të parashikuara nga Programi, për shkaqe që nuk kanë të bëjnë me Palën Italiane.
2. Pengesë e zgjatur në kohë apo forcë madhore në bazë të nenit paraardhës 12.

b) Në dy rastet e përmendura më lart, MPJ/DPKZH mund të vendosë në mënyrë të njëanshme përfundimin e Marrëveshjes, duke ia njoftuar atë MM-së dhe MF-së përmes një note verbale të paktën tre muaj më parë. Sidoqoftë, pas një njoftimi të tillë, MM-ja është e detyruar të ndërpresë veprimtaritë e Programit, me përjashtim të rastit kur Palët kanë rënë dakord ndryshe.

Neni 14

Ndryshimi

a) Palët munden në çdo kohë të propozojnë ndryshime në përmbajtjen e kësaj Marrëveshjeje përmes rrugëve diplomatike. Amendamentet a ndryshimet e mundshme, për të cilat Palët bien dakord, do të hyjnë në

fuqi sipas procedurave të parashikuara sipas nevojës.

Neni 15

Hyrja në fuqi, kohëzgjatja dhe denoncimi

a) Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të dytë, ndër dy njoftimet e kryera, me të cilin Palët Kontraktuese do të kenë njoftuar zyrtarisht kryerjen e procedurave përkatëse të brendshme, të parashikuara sipas nevojës.

b) Kjo Marrëveshje do të ketë një kohëzgjatje trevjeçare dhe do të ripërtërihet heshturazi për periudha të mëtejshme me të njëjtën kohëzgjatje.

c) Kjo Marrëveshje mund të denoncohet në çdo kohë dhe denoncimi do të ketë efekt gjashtë muaj pas njoftimit të saj te Pala tjetër Kontraktuese.

Në besim të sa më sipër, të nënshkruarit përfaqësues, rregullisht të autorizuar nga qeveritë përkatëse, nënshkruan këtë Marrëveshje.

U shkrua në Tiranë më 2006, në dy kopje origjinale, çdonjëra në gjuhën italiane dhe shqipe. Në rast mospërputhjeje interpretimi, do të kryesojë teksti në gjuhën italiane.

ANEKSI 1

PËRMBLEDHJE E PROGRAMIT

1. Përshkrimi

Programi parashikon pajisjen e plotë të Qendrës Traumatologjike Kombëtare me pajisjet e duhura mjekësore dhe orenditë, me qëllim që ta bëjë më efiçente e më efikase veprimtarinë e saj terapeutike për shëndetin e popullsisë, pra të përmirësojë prognozën *quoad valitudinem* e pacientëve politraumatikë, që do të shpjerë në uljen e paaftësive të përkohshme dhe të përhershme dhe të kostove përkatëse që shoqërojnë këto të fundit. Furnizimi me aparatura mjekësore dhe orendi u bashkohet shërbimi i asistencës dhe mirëmbajtjes, i shoqëruar nga një plan trajnimi klinik të specializuar dhe një sasi e caktuar materialesh konsumi për *start up* (vënien në punë) të aparaturave.

Shuma e përgjithshme e kredisë prej 5 milionë euro përfshin në vetvete furnizimin me:

- aparatura biomjekësore dhe orendi (4.6 milionë euro);
- asistencë, mirëmbajtje dhe trajnim (0.22 milionë euro);
- materiale konsumi (0.18 milionë euro).

Pjesa e donacionit, që do të administrohet drejtpërsëdrejti nga DPKZH, siç sqaruar më mirë në vijim, ka për qëllim veprimtarinë e asistencës teknike dhe të kontrollit në ministrinë përfituese (0.15 milionë euro).

Furnizimi me aparaturat mjekësore bazohet në rilevimet e zhvilluara gjatë fazës së hartimit dhe në “Master Plan of Emergency Department and dhe Operation Unit of National Trauma Center”.

Programi përbëhet nga tri elemente (elementi i kredisë):

A. Furnizimi i aparaturave biomjekësore dhe orendive

Kooperacioni italian financon, me kredi ndihmëse, aparaturat biomjekësore dhe orenditë e nevojshme për ndihmën e shpejtë, bllokun operator, reanimacionin, shtrimet sipas specialiteteve të ndryshme kirurgjikale dhe morgun.

Furnizimi do të përfshijë edhe një shërbim diagnostikimi me imazh që do të përbëhet nga një njësi radiologjie dhe në njësi për rezonancën magnetike. Duke pasur parasysh specifikën e shërbimit të ofruar nga Qendra Traumatologjike Kombëtare, vendosja e shërbimit të rezonancës magnetike në këtë Qendër konsiderohet shumë e rëndësishme për rritjen e cilësisë dhe efikasitetit terapeutik të Qendrës, si dhe për rritjen e treguesit të mbulimit në nivel kombëtar të këtij shërbimi diagnostikues.

Kujdes i veçantë duhet treguar ndaj homogjenitetit të teknologjisë, cilësisë dhe thjeshtësisë në përdorimin e mirëmbajtjen e aparaturave.

Njësitë që do të pajisen me financimin italian do të jenë:

a.1. Ndihma e shpejtë:

Përsa i përket ndihmës së shpejtë, furnizimi do të konsistojë në pajisjen e një mjedisi për pranimin dhe ndjekjen e pacientëve, dy salla operacioni për pranimin dhe ndjekjen e pacientëve, dy salla operacioni për trajtimin e pacientëve politraumatikë (sallat trauma), një sallë operacioni për ndërhyrje të kirurgjisë së përgjithshme, një laborator për analiza klinike të urgjencës, një sistem informacioni për menaxhimin e pranimeve dhe të gjitha mjediseve të shërbimit shtesë për funksionimin e rregullt të shërbimit të urgjencës.

a.2. Blloku operator:

Blloku operator do të përbëhet nga pesë salla operacioni të pajisura sipas tipologjive të ndryshme të ndërhyrjeve kirurgjikale dhe me mjediset e nevojshme për funksionimin e rregullt të tij si: filtra, hapësira për përgatitjen e pacientëve, sterilizimin, nënsterilizimin dhe mjedise shërbimi për stafin e sallës së operacionit. Sallat e operacionit që parashikohen të pajisen janë: një sallë për ndërhyrjet ortopedike, një sallë për ndërhyrjet neurokirurgjike dhe tri salla për ndërhyrjet në urologji, gastroenterologji, kirurgji vaskulare, gjinekologji,

otorinolaringoiatri dhe okulistikë.

a.3. Terapi intensive (reanimacion):

Reanimacioni (terapia intensive) do të organizohet në tre sektorë kryesorë: zona e terapisë intensive (8 shtretër, 1 prej të cilëve për pacientë të infektuar dhe 2 për pacientë me djegie), zona e terapisë subintensive (8 shtretër), dhoma e kontrollit.

a.4 Diagnostikimi me imazh:

Diagnostikimi me imazh do të përbëhet nga një njësi radiologjike dhe një rezonancë magnetike. Shërbimi i radiologjisë do të përbëhet nga një aparaturë radiologjike fikse dhe nga një sistem për fluoroskopinë. Ky shërbim do të pajiset me të gjithë aksesorët dhe mjediset e nevojshme për funksionimin e tij.

Rezonanca magnetike që mendohet të ofrohet do të jetë e llojit me "magnet fiks" për aplikime ortopedike dhe traumatologjike. Ky furnizim duhet të përfshijë të gjitha hollësitë e nevojshme për funksionimin e rregullt të impiantit.

a.5 Shtrimet:

Shtrimet do të pajisen me gjithë sa është e domosdoshme. Parashikohet të furnizohen shtretërit për shtrimet dhe orenditë më të nevojshme përkatëse për të gjithë 120 shtretërit në repartet e ndryshme.

a.6 Salla e morgut:

Morgu do të parashikojë pajisjen e sallës për ruajtjen e kufomave, sallën për autopsinë dhe pajisjen e mjediseve ndihmëse, si ato të përgatitjes së mjekëve dhe sterilizimit.

Është parashikuar një zë shpenzimi (a.7 Energji elektrike e vazhdueshme) për blerjen e aparaturave që janë në gjendje të sigurojnë vazhdimësinë e shërbimit të energjisë elektrike, sidomos për njësitë operative, funksionimi i të cilave është kritik për shëndetin e pacientit ose ruajtjen e aparaturave. Parashikohet për këtë arsye furnizimi i grupeve statike të rrymës së vazhdueshme (UPS), vendosja dhe përdorimi i të cilave do të përcaktohen gjatë hartimit të planit të përgjithshëm për pajisjet. Në mbështetje të këtyre grupeve do të shihet mundësia për të përfshirë furnizimin e një gjeneratori. Parashikohet, gjithashtu që ky zë të përdoret për një përshtatje të mundshme të rrjetit elektrik sipas normativës europiane.

B. Furnizimi i një plani për asistencë dhe mirëmbajtje

Për të siguruar funksionimin e plotë të aparaturave biomjekësore, Programi duhet të ofrojë furnizimin me aparatura, përveç trajnimit specifik, por edhe një plan asistence e mirëmbajtje për një shërbim të plotë e të përgjithshëm, që bën të mundur përballimin e nevojave që mund të lindin në fazën e parë të vënies në punë të aparaturave biomjekësore. Ky plan asistence dhe mirëmbajtjeje do të konsistojë në ndërhyrje si për ndreqjen, ashtu dhe për parandalimin e problemeve. Ky plan asistence përfaqëson një element thelbësor për qëndrueshmërinë e ndërhyrjes pasi, nëse do të menaxhohej ashtu siç duhet dhe do të shoqërohej nga personel teknik lokal, do të ishte një mundësi e mirë për transferimin e njohurive.

Kohëzgjatja e këtij plani asistence dhe mirëmbajtjeje duhet të jetë njëvjeçar. Mendohet se kjo është kohëzgjatja e përshtatshme për të nisur këtë transferim të nevojshëm të kompetencave.

C. Furnizim i materialeve të konsumit

Furnizimi i të mirave parashikon një sasi të përshtatshme materialesh konsumi për aparaturat kryesore që shërbejnë për të kapërcyer fazën kritike të vënies në punë të njësive që do të pajisen.

2. Kohëzgjatja e ndërhyrjes

Ndërhyrja e financuar me kredi ndihme do të ketë një kohëzgjatje të përgjithshme prej 24 muajsh.

Gjatë periudhës së parë gjashtëmujore, duhet të kryhet puna përgatitore për tenderin, që duhet financuar nëpërmjet donacionit.

3. Plani i shpenzimeve dhe livrimeve

Burimet e financimit italian do të mund të përdoren vetëm për veprimtaritë e parashikuara nga kjo Marrëveshje. Rialokimet dhe rregullimet mes zërave të veçantë të parashikuar për furnizimet, asistencën, mirëmbajtjen dhe trajnimin, si dhe për materialet e konsumit, siç parashikohet në tabelën 1, në rritje apo në ulje, brenda një shume maksimale prej 20% dhe sidoqoftë pa ndryshuar shumën e përgjithshme, mund të vihen nga enti zbatues. Ndryshime më të mëdha se 20% duhet t'i nënshtrohen miratimit të Qeverisë Italiane.

4. Në ngarkim të palës shqiptare do të jenë:

a) përjashtimet nga taksat e tatimet;

b) shpenzime më të mëdha të mundshme për të papritura dhe rishikim të çmimeve.

Në asnjë rast fondet e financimit italian nuk mund të përdoren për të paguar tatimet vendore dhe ato doganore ose TVSH-në. Furnizimet dhe shërbimet e importuara në lidhje me realizimin e projektit do të përjashtohen nga çdo tatim apo taksë doganore shqiptare.

5. Raporti përfundimtar (RP)

RP do të përgatitet nga Drejtoria e Spitalit Ushtarak të Tiranës në fund të projektit e pasi të ketë marrë më parë miratimin e MM, ai i dërgohet MPJ/DPKZH. RP do të ketë këtë strukturë të përgjithshme: i) përmbledhje e përmbajtjes së projektit; ii) përshkrim i modaliteteve të zbatimit të projektit (tenderat, kalendari, shumat, realizime e ndryshime, kosto, financimi, performancë e ndërmarrjeve dhe enti zbatues); iii) performancë

e projektit (operative, institucionale e financiare; iv) ndikimet (ekonomike, shoqërore, mjedisore etj.); v) qëndrueshmëria e projektit; vi) performancë e DPKZH dhe Qeverisë; vii) performancë e përgjithshme; viii) përfundime e rekomandime.

6. Kostot e Programit (në ngarkim të kooperacionit italian)

Në tabelën e mëposhtme janë përmbledhur, vetëm për t'i treguar ato, kostot e llogaritura në zërat e ndryshëm.

Tab.1

KUADRI I PËRGJITHSHËM I KOSTOVE TË LLOGARITURA TË PROGRAMIT

			Totali (€)	Shuma (€)
A	Pajisje mjekësore dhe orendi		4 800 000	
	A.1	Pajisja e ndihmës së shpejtë (urgjenca)		805 000
	A.2	Pajisja e bllokut operator (sallat e operacionit)		1 430 000
	A.3	Pajisja e repartit të reanimacionit (terapia intensive)		630 000
	A.4	Pajisja e repartit të shtrimeve		360 000
	A.5	Pajisja e shërbimeve të bioimazheve		1 205 000
	A.6	Pajisja e morgut		50 000
	A.7	Energji elektrike e vazhduar		80 000
B	Shërbimi i asistencës, mirëmbajtjes, trajnimit		220 000	
C	Materiale shërbimi dhe pjesë këmbimi		180 000	
		Kredia	5 000 000	
D	Misione të DPKZH		150 000	
	D.1	Viti 2006		100 000
	D.2	Viti 2007		50 000
		Donacioni (Fondi për ekspertë)	150 000	
		Totali i përgjithshëm i Programit	5 150 000	

ANEKSI 2
PROKURIM SHËRBIMESH, FURNIZIMESH DHE PUNIMESH
(KUSHTET E VEÇANTA)

Kjo Marrëveshje i referohet përdorimit të kredisë së ndihmës italiane.

Caktimi i kontratave do të kryhet përmes tenderave, ku mund të marrin pjesë vetëm shoqëritë italiane. Përqindja e kredisë së ndihmës që mund të përdoret për kostot lokale dhe/ose në vendet në zhvillim nuk mund të jetë më e lartë se 40% e vetë kredisë.

Për caktimin e gjithë kontraktimeve të parashikuara në Program, do të ndiqen procedurat e parashikuara në manualin e procedurave (përfituar nga Komisioni Europian i datës 23 dhjetor 2002) dhe ndryshime të mëtejshme të mundshme, në lidhje me: prokurim shërbimesh, furnizimesh dhe punimesh në kuadrin e bashkëpunimit të Komunitetit Europian me vende të treta.

Në çdo rast, procedura e përzgjedhjes duhet të përfshijë sidoqoftë:

- kontrollin e përshtatshmërisë së ofertuesve (persona juridikë, shoqëri dhe ndërmarrje), që nuk do të gjykohen të përshtatshme nëse:

a) gjenden në kushte falimentimi, likuidimi, administrimi të kontrolluar apo marrëveshje paraprake për shpalljen e gjendjes së falimentimit, ndërprerjeje të aktivitetit apo kur janë objekt i një procedure të ngjashme, parashikuar nga ligjet e rregulloret kombëtare;

b) janë objekt i një procedurë për shpallje falimentimi, likuidimi, administrimi të kontrolluar, marrëveshjeje paraprake për shpallje gjendje falimentimi apo i një procedure të ngjashme, siç është parashikuar nga ligjet e rregulloret kombëtare;

c) kanë marrë një dënim për një krim në lidhje me moralin profesional, për të cilin nuk mund të paraqitet ankim;

d) janë konsideruar përgjegjës për shkelje të rënda të detyrës profesionale, provuar me çdo element të dokumentueshëm nga administrata tenderuese;

e) nuk kanë shlyer rregullisht detyrimet e sigurimeve shoqërore sipas dispozitave ligjore të vendit ku janë vendosur;

f) nuk kanë shlyer rregullisht detyrimet në tatime e taksa sipas dispozitave ligjore të vendit ku janë vendosur;

g) janë shpallur fajtorë, për shkak të mosrespektimit të detyrimeve kontraktore, për mospërmbushje të

rëndë në lidhje me zbatimin e një tjetër kontrate të nënshkruar me po këtë administratë prokuruese ose në lidhje me një kontratë tjetër të financuar me fonde të Komunitetit Europian.

Gjithashtu, ofertuesit italianë do të jenë të detyruar të paraqesin një certifikatë apo një deklaratë të barasvlefshme për mospërkatësi në kategoritë e treguara në dekretin legjislativ italian të datës 8 gusht 1994, nr.490 "Antimafia".

Për këtë arsye ofertuesit, në mbështetje të ofertave të tyre, duhet të paraqesin provat e zakonshme, në përputhje me legjislacionin e vendit në të cilin ato janë vendosur, të cilat provojnë që ata nuk ndodhen në asnjë prej rrethanave të parashikuara në pikat (a), (b), (c), (e) dhe (f).

- Kontroll i gjendjes ekonomike e financiare të ofertuesve, përmes:

a) deklarimit të kapitalit shoqëror të shoqërisë dhe të ardhurave në tre vjetët paraardhës të tenderit;

b) një deklaratë për të ardhurat totale të konkurruesve dhe, në rast asocimi të përkohshëm, të ardhurat e secilit prej pjesëmarrësve në këtë bashkim tregtar;

c) një deklaratë e cila dëshmon të ardhurat në sektorët specifikë të cilëve u referohet tenderi apo në sektorin ku, në rast asocimi të përkohshëm, shoqëria individuale mendon të kontribuojë;

d) një deklaratë të përshtatshme të përfaqësuesve ligjorë apo një dëshmi bankare, që përmban të dhëna mbi marrëdhëniet me institutet bankare me rëndësi në nivel ndërkombëtar që kërkojnë të dëshmojnë pranueshmërinë tregtare dhe financiare të konkurruesve dhe shoqërive që përbëjnë asocimin e përkohshëm;

e) një kopje e dëshmisë që vërteton se konkurruesi është anëtar i dhomës së tregtisë në vendin ku ndodhet;

f) në rast asocimi të përkohshëm, duhet të paraqitet një kopje e kontratës së asocimit të përkohshëm, ku tregohet shoqëria që do të jetë përgjegjëse para MPJ (MIE) për zbatimin e mundshëm të kontratës.

- Kontrolli i aftësisë teknike e profesionale të konkurruesve përmes:

a) një kopje të dokumenteve origjinale, që vërtetojnë përbërjen ligjore, statusin juridik dhe që përcaktojnë vendin e regjistrimit dhe/ose selinë kryesore ose zyrën e regjistrimit e, nëse këto nuk përkojnë, vendndodhjen e selisë kryesore të kompanisë, shoqërisë ose partnershipit të zakonshëm, apo të pjesëve të ndryshme që përbëjnë konkurruesit, në rast asocimi të përkohshëm;

b) një raport që përmban të dhëna të dokumentuara mbi përvojat e mëparshme të punës së konkurruesve apo të asocimit të përkohshëm në tendera që kanë pasur natyrë të ngjashme, në tre vjetët paraardhës, dhe në lidhje me prokurime të tjera në zhvillim e sipër, me të dhëna specifike mbi pjesëmarrjen konkrete dhe efektive në çdo tender;

c) cilësitë dhe përvojën e anëtarëve më të rëndësishëm të stafit, të cilët do të jenë të ngarkuar nga kontraktuesi për zbatimin e kontratës;

d) një raport të shkurtër mbi aktivitetin e konkurruesve, më vete apo të asociuar, duke iu referuar në mënyrë specifike veprimtarive në lidhje me Programin.

Pjesëmarrja i nënshtrohet paraqitjes së një vetëcertifikimi që vërteton kontrollin në vendet e ndërhyrjes.

Krahasimi i konkurruesve, në bazë të kritereve të përcaktimit të fituesit, siç përcaktohet në njoftimin dhe në dosjen e tenderit, do të kryhet në bazë të kritereve të përcaktuara më parë dhe të çmimit, për të përcaktuar konkurruesin që është më i leverdisshëm nga pikëpamja ekonomike.

Kriteret duhet të jenë të sakta, jo diskriminuese, e as nuk duhet të paragjykojnë konkurrimin e rregullt.

ANEKSI 3
MODALITETET E ZBATIMIT DHE MENAXHIMIT TË KREDISË SË NDIHMËS

SEKSIONI I
NXJERRJA E SHPALLJES SË TENDERIT DHE PROCEDURA ZBATUESE

Dokumentacioni duhet të përgatitet në përputhje me aneksin 2, që i referohet manualit të procedurave (përfituar nga Komisioni Europian, më datë 23 dhjetor 2002) dhe ndryshime të mëtejshme të mundshme, në lidhje me: prokurim shërbimesh, furnizimesh e punimesh në kuadrin e bashkëpunimit të Komunitetit Europian me vende të treta. Dokumentacioni, sidoqoftë, duhet:

- të specifikojë "kushtet e veçanta" në lidhje me secilin tender;
- të tregojë qartë kriteret e vlerësimit që do të përftohen nga komisioni i ngritur nga MM.

1. Përgatitja e dokumentacionit të tenderit

MM do të përgatisë dokumentacionin e tenderit për përzgjedhjen e fituesve (punime dhe supervizion punimesh) dhe do t'ia përcjellë/ambasadës/ZTL me kërkesën për të botuar shpalljen e tenderave në gazetat italiane.

2. Kontrolli i përputhshmërisë së dokumentacionit të tenderit

Kontrolli i përputhshmërisë me këtë Marrëveshje do të kryhet nga MPJ/DPKZH dhe do të mbështetet, veçanërisht, në përputhjen e:

-përmbajtjes me karakter ligjor me procedurat e treguara nga aneksi 2;

-teknikave specifike dhe parametrave të vlerësimit me objektivat që Programi synon të arrijë.

3. Botimi i shpalljes së tenderit

Në rast përfundimi pozitiv të kontrollit, shpalljet e tenderave do të botohen nga ana e MPJ/DPKZH në gazetat e përditshme italiane, në buletinin e kooperacionit dhe në faqet e internetit të MPJ. MM do të procedojë njëkohësisht me botimin e shpalljes së tenderave në gazetat e përditshme kombëtare.

SEKSIONI II
FAZA E CAKTIMIT TË FITUESIT- PROCEDURA ZBATUESE

1. Shqyrtimi i ofertave të paraqitura për çdo tender do të kryhet nga një komision vlerësimi i ngritur enkas nga MM. Në hapjen e ofertave do të marrë pjesë në cilësinë e vëzhguesit një përfaqësues i caktuar nga ambasada/ZTL.

2. Për çdo tender, MM do t'i përcjellë ambasadës /ZTL dokumentacionin që përmban aktet e komisionit, së bashku me kontratën që duhet të lidhet, duke kërkuar të jepet miratimi për lidhjen e saj. Ky dokumentacion do të përcillet nga ambasada/ZTL pranë MPJ/DPKZH me komentet e rastit.

3. MPJ/DPKZH do të kontrollojë kryesisht përputhjen ligjore e teknike të vlerësimeve të kryera me procedurat e kriteret/parametrat e parashikuar në pjesën e posaçme të tenderit. Pasi të kenë përfunduar verifikimet, MPJ/DPKZH do të njoftojë ambasadën/ZTL për rezultatin e tyre.

4. Në rast se verifikimi do të ketë rezultat pozitiv (nuk ka asnjë pengesë), MM do të procedojë me lidhjen e kontratave me shoqëritë e shpallura fituese.

SEKSIONI III
FAZA E LIDHJES SË KONTRATAVE DHE LIVRIMEVE, PROCEDURA ZBATUESE

1. Kontratat e lidhura zyrtarisht mes shoqërive fituese dhe MM duhet të dërgohen në MPJ/DPKZH, së bashku me një kopje të *performance bond* dhe të sipërpërmendurit miratim (*nulla osta* – nuk ka asnjë pengesë) me një deklaratë angazhimi lëshuar nga pala shqiptare, për të përballuar kostot lokale (tatimi mbi vlerën e shtuar, taksa doganore, shpronësime etj.).

2. Pasi të merret e shqyrtohet dokumentacioni, MPJ/DPKZH do të kujdeset të autorizojë Artigiancassa që kjo e fundit të lidhë kontratën në linjën e kredisë.

3. Sapo të ketë marrë miratimin e mësipërm, siç në pikën 2, Artigiancassa do të plotësojë praktikën përgatitore, në veçanti atë për eksportuesin italian. Më pas, kur praktika përgatitore të jetë përfunduar me sukses dhe të jetë marrë kërkesa për financim nga ana e kredimarrësit, Artigiancassa do t'i njoftojë këtij të fundit, eksportuesit italian dhe MPJ/DPKZH hyrjen dhe financimin e kontratës në linjën e kredisë.

4. Artigiancassa do t'i japë udhë livrimit të fondeve drejtpërsëdrejti te furnizuesit pasi të ketë marrë prej tyre kërkesën për livrim së bashku me dokumentacionin administrativ bashkëngjitur, siç parashikohet në kontratat e veçanta (fatura tregtare, *packing list, bill os lading* etj.) dhe pasi të ketë kontrolluar përputhshmërinë e vetë dokumentacionit me kontratën e autorizuar (një kopje e kërkesës për livrim do t'i dërgohet kredimarrësit). Pagesat mund të urdhërohen vetëm pas miratimit për të proceduar nga ana e kredimarrësit; ky autorizim duhet të mbërrijë sidoqoftë brenda e jo më vonë se 30 ditë nga data e paraqitjes së çdo kërkese: përtej kësaj date, mospërgjigja nga ana e administratës do